

V E N D I M
Nr. 571, datë 22.10.2001

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, TË
CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I VARREZAVE PUBLIKE NË KOMUNËN GJEGJAN,
PUKË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 dhe 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurisë së paluajtshme të pronarit, që preket nga ndërtimi i varrezave publike, në komunën Gjegjan, Pukë.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të komunës Gjegjan, Pukë.
 3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, që shpronësohet, të kompensohet, në vlerë të plotë, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen prej 1240 m² tokë, arë dhe truall, në shumën e përgjithshme prej 396 800 (treqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind) lekësh.
 4. Ky fond përballohet nga fondet e programit të investimeve publike, zëri "Investime për shpronësime", miratuar për Ministrinë e Punëve Publike dhe Turizmit.
 5. Shpenzimet për realizimin e procedurave të shpronësimit dhe kompensimit të jenë në ngarkim të komunës Gjegjan, Pukë, kërkuesit për shpronësim, në shumën 138 000 (njëqindtridhjetë mijë) lekë.
 6. Shpronësimi të fillojë dhe të përfundojë në periudhën 10 deri më 30 nëntor 2001.
 7. Paga e pronarit të shpronësuar të kryhet nga komuna Gjegjan, Pukë.
 8. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Turizmit dhe prefektura e qarkut të Shkodrës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

**LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR ZGJERIMIN E
VARREZAVE PUBLIKE KOMUNA GJEGJAN (PUKË)**

Nr	Emri, atësia, mbiemri	Sipërfaqja m ²	Çmimi lek/m ²	Vlera në lekë
1	Mark Nikollë Gjini	1240	320	396.800